

## KUSHTET E PJESËMARRJES PËR PUBLIKUN « QYTETI ËSHTË I JUAJI »

« Qyteti është i juaji » është një festë e madhe, falas dhe e hapur për të gjithë. Ajo ka për qëllim zënien e rrugëve të qytetit përgjatë një fundjave.

### TË GJALLËROJMË RRUGËN

- \* Gjithsecili mund të zërë një vend për të propozuar një aktivitet falas ose me pagesë (lojra, berber, ilustrues këpucësh, muzikë, skeçe...)
- \* Aktivitetet e lëvizshëm janë të mirëseardhur (fanfarë, teatër rruge...)

### TË ZBRAZIM PAPAFIGOT-BODRUMET

- \* Vetëm individët mund të marrin pjesë për të zbrazur papafingot - bodrumet.
- \* Autorizohen për shitje vetëm sendet **personalë dhe të përdorur**.
- \* Secili merr mbrapsht sendet e tij të pashitur.

### NUK AUTORIZOHEN

- \* Shitja e sendeve të reja, produkteve në seri ose në mënyrë industriale
- \* Prozelizimi, propaganda ose publiciteti

### INSTALIMI

- \* Pa rregjistrim
- \* Sipërfaqja e vend instalimit është 3 metra lineare

**Banorët e lagjes** (banorët dhe bizneset që ndodhen në perimetrin e festës ) **mund të zgjedhin një vend duke filluar nga ora 7:30.**

**Pjesëmarrësit e tjerë mund të futen në rrugë duke filluar nga ora 8:00:**

NË FILLIM,

Rrugët do të hapen për **fëmijët, të moshuarit dhe personat me lëvizshmëri të kufizuar**, të shoqëruar nga ekipi ynë i pritjes

PASTAJ,

Pasi të jenë instaluar këta persona, festa është e hapur për **të gjithë**

- \* Muzika e amplifikuar në stenda

### KUJDES!

- \* **Gjerësia e rrugës që duhet të ngelet e lirë për kalimin e ambulancës në rast nevoje, duhet të jetë 3,5m.**
- \* Nuk do t'ju furnizohet asnjë material, secili ia del si di vetë!
- \* Disa vende instalimi janë të rezervuar për programin ose vullnetarët
- \* Nuk duhet lënë asnjë objekt në rrugën publike

### STENDAT PËR USHQIME

- \* Vetëm stendat e rregjistruara pranë komitetit organizator mund të shesin ushqime
- \* Kafet, çajrat, biskotat dhe piknikët e shpërndarë janë të mirëseardhur! (pa rregjistrim)
- \* Secili kujdeset për sistemimin e plehrave të tij dhe përdor koshat e vënë në dispozicion.

### QARKULLIMI

- \* Perimetri është i mbyllur për automjetet gjatë kohëzgjatjes së manifestimit, dhe kjo, nga e shtuna ora 6:00 deri të dielën në orën 23:00.
- \* Parkingët privatë janë të arritshëm për banorët e lagjes.